



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:017373
Datë: 22.01.2024
Numri i dokumentit: 05218528

C-IV-14-6657

Parashtruesi i kërkesës

E Sh, të cilin e përfaqëson avokat D B, nga Ferizaji

Kundër

Pala kundërshtare

Agjencia Kosovare e Privatizimit- (AKP) (NSH “Eurometal” në likuidim), Rr. ‘Dritan Hoxha’ nr.55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 22 janar 2024, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- 1. Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar.**
- 2. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit GJI057-0337 datë 5 shkurt 2014.**
- 3. Refuzohet kërkesa e përfaqësuesit të ankuesit për kompensimin e shpenzimeve gjyqësore.**
- 4. Secila palë i mbulon shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 21 tetor 2014, ankuesi pranë DHPGJS, parashtror kërkesë, të emërtuar padi, për rishikimin e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL), GJI057-0337 datë 5 shkurt 2014 (në tekstin e mëtutjeshëm Vendimi), me të cilin i është refuzuar kërkesa, parashtruar nga ana e Shoqatës Sindikale të Pavarur të NSH, për kompensim për paga të papaguara për periudhën maj gjer tetor të vitit 1990, në shumë prej 531,774.00 (pesë tre një shtatë shtatë katër) Euro, ndaj NSH “Eurometal” (në likuidim).

Ankuesi fillimisht përfaqësohej nga avokat, R A, tani i ndjerë.

Ankuesi pohon se pa bazë ligjore nuk i janë paguar të ardhurat personale prej muajit maj gjer muajin tetor të vitit 1990, gjersa në muajin nëntor të njëjtit vit janë larguar nga puna, sipas ankuesit, me një vendim arbitrar nga këshilli i përkohshëm i ndërmarrjes.

Ankuesi pohon se kundër vendimit, për largim nga puna, kanë ushtruar padi në gjykatën kompetente dhe se kjo padi është akoma e pavendosur.

Sipas ankuesit, fakti se nuk i janë paguar pagat për periudhën e kërkuar kjo mund të vërtetohet nga lista e pagesave dhe mos-pagesave për vitin 1990, nr. 114 datë 7 maj 1991 dhe shkresat e datë 6 maj 1991.

Nga gjitha arsyet, e cekura si më lartë, ankuesi kërkon që kërkesa e tij, për periudhë maj gjer në muajin tetor 1990 të aprovohet, në shumë prej 1,103.00 me kamatë vjetore duke filluar nga muaji prill 2006 e deri në pagesën definitive.

Kërkesës për rishikim i janë bashkangjitur:

- Kopja e autorizimit për përfaqësuesin, R A
- Një kopje e regjistrimit, nr. 8 datë 27 mars 2006, mbi realizimin e borxhit ndaj punëtorëve të NSH, për muajt maj gjer tetor të vitit 1990,
- Kopja e padisë, parashtruar pran Gjykatës Themelore të Punës së Bashkuar- Prishtinë, nga një grup i paditësve – punëtorëve,
- Kopje e autorizimit për përfaqësuesin D B,
- Kopja e shkresës, e titulluar Informatë, nr. 3142 datë 2 tetor 1990,
- Një kopje e shkresës, nr. 1128 datë 6 maj 1991, nga NSH drejtuar Shërbimit të Kontabilitetit Shoqëror- Ferizaj, ku ndër të tjerash cekën edhe numri i punëtorëve të cilëve nuk i janë paguar të ardhurat e garantuara personale nga muaji maj gjer dhjetor,
- Një kopje e shkresës, nr. 114 datë 7 maj 1991, nga NSH drejtuar Shërbimit të Kontabilitetit Shoqëror- Ferizaj, ku ndër të tjerash cekën edhe numri i punëtorëve të cilëve nuk i janë paguar të ardhurat e garantuara personale nga muaji maj gjer dhjetor,
- Kopja e ftesës për seancë gjyqësore, drejtuar A I, për datë 10 tetor 1991,
- Një kopje e shkresës e dorë shkruar,
- Një kopje e regjistrimit, nr. 677 datë 4 korrik 2002, mbi realizimin e borxhit ndaj punëtorëve të NSH, për muajt maj gjer tetor të vitit 1990.
- Kopje e shkresës drejtuar AKP, nga ana e Sindikatës së pavarur të NSH, datë 10 maj 2013,
- Kopja e shkresës së Gjykatës themelore në Ferizaj, datë 10 maj 2013, dhe
- Kopja e Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac.nr.251/2006 datë 21 janar 2008.

Me parashtrësën datë, 18 janar 2022, gjykata u informua nga përfaqësuesi i ankuesit mbi vdekjen e përfaqësuesit fillestar, avokat R A dhe se tani e tutje ankuesi përfaqësohet nga avokat D B. Me të njëjtën parashtrësë u kërkuan kompensimin e shpenzimeve procedurale.

Duke vepruar sipas urdhrin të gjykatës përfaqësuesi i ankuesit, me anë të parashtrësës së parashtruar pranë DHPGJS me 9 tetor 2023, parashtror kopjen e kërkuar të Vendimit të AL.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 21 nëntor 2023 parashtror përgjigjen.

AKP kundërshtor kërkesën për rishikim-ankesat duke e konsideruar si të pabazuar. AKP konsideror se AL ka bërë një vlerësim të saktë si të rrethanave faktike e po ashtu se dispozitat

ligjore janë zbatuar në mënyrë të drejtë. Tutje, sipas AKP, kërkesa për rishikim-ankesa nuk përmban argumentet e saj ligjore, ashtu siç edhe parashihet sipas dispozitave ligjore të Shotjçës së Ligjit për AKP dhe Ligjit për procedurën kontestimore – LPK. Përfundimit AKP pohoj se kërkesa kreditore e ankuesit është e pabazuar respektivisht e parashkruar. Nga gjitha arsyet propozon që kërkesa për rishikim të hedhet si e papranueshme ose refuzohet si e pabazuar dhe Vendimi i AL të vërtetohet.

Përgjigjes i është bashkangjitur:

- Kopja e Vendimit të AL.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, përfaqësuesi i ankuesit parashtror përgjigjen, ndaj përgjigjes së AKP, me 20 dhjetor 2023.

Me anë të përgjigjes u kundërshtua përgjigja e AKP dhe ankuesi mbeti në tërësi si pranë kërkesës për rishikim. Me përgjigje i referohej përmbushjes dhe parashtrimit të gjitha fakteve dhe provave, pranë AL, të listuara si në përgjigje.

Me Aktvendimin e gjykatës, datë 11 janar 2024, ankuesi është liruar nga pagesa e taksave gjyqësore.

Arsyetimi ligjor:

Kërkesat për rishikim-ankesa konsiderohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Ankuesi me anë të kërkesës së saj për rishikim-ankesës, ka kërkuar rishikimin e Vendimit të AL, të Shoqatës Sindikale të Pavarur të NSH, sipas së cilit është vendosur lidhur me pagat e papaguara për periudhën maj gjer tetor të vitit 1990.

Në rastin konkret bazuar sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS është obligim i palës, në këtë rast ankuesit, që në parashtratat e tij me shkrim, ankesën, të paraqesë një pasqyrë të hollësishme të fakteve dhe arsyetimit ligjor mbi të cilin vendos qëndrimin dhe argumentimin e saj. Në rastin kur pala pohon, në këtë rast ankuesi, të ekzistojë një fakt, ajo palë është e obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuese, për mbështetjen e atij pohimi.

Dokumentacioni apo dëshmitë e parashtruara, nga ana e ankuesit, të cilat i janë bashkangjitur kërkesës për rishikim e të listuar si më lartë, nuk përbëjnë argument dhe provë me të cilat do të dëshmohej anulimi apo ç'fuqizimi i vendimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, ashtu siç edhe ceket në ankesën e ankuesit, e që si rezultat do të tërhiqte edhe të drejtën për paga të papaguara, për periudhën e kërkuar të vitit 90'. Të gjitha shkresat e parashtruara, paraqesin vetëm se dëshmi se është inicuar çështja e kontestit nga marrëdhënia e punës, por nuk paraqesin dëshmi se ankuesit i është njohur e drejta nga ky kontest nga marrëdhënia e punës, e që si rezultat do ti njihej edhe e drejta e kompensimit në paga.

Gjykata konsideron se lidhur me pagat e papaguara, si rezultat i shitjes apo privatizimit apo edhe likuidimit nga ana e AKP, duke u bazuar në nenin 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP mbi

prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 parashihet përmbushja e kërkesave për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në .

Nga dispozitat e lartcekura, mund të konkludohet se, punëtori gëzon të drejtën në paga nëse:

- a. pagat e punonjësit, në këtë rast ankuesit, nuk janë paguar;
- b. pushimi nga puna ka ardhur si pasojë i Vendimit të AL, dhe
- c. ndonjë veprim nga Agjencia, lidhur me administrimin e ndërmarrjes, shitjes, likuidimit etj.

Tutje sipas nenit 40 paragrafi 1.7 parashihet përmbushja e kërkesave përfshirë kërkesat e pasiguruara, përfshirë kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë

Ankuesi, në rastin konkret, nga dëshmitë e parashtruara, nuk ka dëshmuar të drejtën e tij mbi pagat ashtu siç edhe parashihet sipas nenit 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 dhe 1.6.2 por edhe paragrafit 1.7 (kërkesat e pasiguruara) të po të njëjtit nen, si edhe nuk ka dëshmuar ndonjë obligim tjetër ashtu siç parashihet sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS.

Nga gjitha arsyet u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Ankuesi është liruar nga pagesa e taksave gjyqësore.

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për DHPGJS, mbi kërkesën e përfaqësuesit të ankuesit për kompensimin e shpenzimeve gjyqësore, u vendos si në pikën 3 të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për DHPGJS secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar